Të dhënat bazë për lëndën	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Shkathtësi Akademike**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**I**
Numri i orëve në javë:	**2**
Vlera në kredi – ECTS:	**3**
Përshkrimi i lëndës	Lënda Shkathtësi Akademike synon zhvillimin e aftësive të studentëve në shkrim, lexim kritik, kërkim dhe komunikim akademik. Studentët njihen me parimet e shkrimit akademik, strukturimin e tekstit, përdorimin dhe citimin e burimeve, hartimin e punimeve kërkimore, redaktimin dhe prezantimin e ideve. Përmes ushtrimeve praktike, studentët zhvillojnë aftësinë për të komunikuar qartë dhe në mënyrë profesionale në kontekstin akademik dhe në fushën e artit, dizajnit dhe multimedias.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është të zhvillojë aftësitë e studentëve për shkrim, kërkim dhe komunikim akademik, duke i aftësuar të strukturojnë dhe argumentojnë idetë, të përdorin burimet në mënyrë të përgjegjshme dhe të prezantojnë punën e tyre në mënyrë të qartë dhe profesionale.
Rezultatet e pritura: **a) Njohuritë** **b) Aftësitë dhe Shkathtësitë** **c) Kompetencat**	Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: • Zbatojë parimet bazë të shkrimit akademik dhe drejtshkrimit; • Strukturojë dhe hartojë një ese dhe një punim të shkurtër akademik; • Kërkojë, përzgjedhë dhe përdorë burime relevante akademike; • Përdorë citimet, referencat dhe bibliografinë në mënyrë korrekte dhe të respektojë parimet e integritetit akademik; • Analizojë, redaktojë dhe vlerësojë tekste akademike; • Komunikojë dhe prezantojë ide në mënyrë të qartë dhe profesionale; • Analizojë dhe prezantojë në mënyrë të argumentuar një vepër, projekt ose produkt nga fusha e artit, dizajnit dhe multimedias.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	3	3
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	1	8	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	3	3	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	3	6
Totali			75

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia realizohet përmes ligjëratave interaktive, diskutimeve, analizës së teksteve dhe burimeve akademike, ushtrimeve individuale dhe grupore, detyrave të shkrimit, prezantimeve dhe punës praktike në hartimin, citimin dhe redaktimin e teksteve akademike.
Vlerësimi:	10% – Aktivitet dhe Angazhim në mësim 20% – Hartimi/prezantimi i projektit punim seminari 70% – Provimi final (ose nga dy teste) Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 % nga te gjitha kriteret e vlerësimit,
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, Power Point, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime praktike,
Literatura	
Literatura bazë:	1. Shamiq, Mid'hat, Si shkruhet vepra shkencore, "Logos A", Shkup, 2006, 2. Memushaj, Rami, Shqipja standarde, "Toena", Tiranë, 2004. 3. Boce, Elona, Si të shkruajmë një punim kërkimor, CDE, Tiranë, 2004.
Literatura shtesë:	1. Musaj, Bardhyl, Si të shkruajmë ese, "Pegi", Tiranë, 2004. 2. Nishku, Majlinda, Procesi dhe shkrimet funksionale, QAD, Tiranë, 2004. 3. Pozzato, Maria Pia, Semiotika e tekstit, UET/Press, Tiranë, 2009. 4. Dhrimo, Ali – Edmond Tupja, Eshref Ymeri,

	Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, “EDFA”, Tiranë, 2007.

Plani i mësimit:	
Java	**Ligjëratat që do të zhvillohen**
Java e parë:	Hyrje në lëndë. Kultura e gjuhës dhe shkrimi akademik – prezantimi i lëndës, metodologjisë, vlerësimit, burimeve dhe literaturës; dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturës së gjuhës dhe shkrimit akademik.
Java e dytë:	Nocionet themelore – gjuha, shkrimi, leximi kritik, shkrimi akademik, drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi.
Java e tretë:	Komunikimi akademik dhe profesional – format dhe parimet e komunikimit në kontekstin akademik dhe profesional, me shembuj nga arti, dizajni dhe multimedia.
Java e katërt:	Leximi kritik, argumentimi dhe formulimi i ideve – identifikimi i argumentit, formulimi dhe mbështetja e ideve.
Java e pestë:	Strukturimi i tekstit akademik – paragrafi, argumenti, koherenca, lidhja ndërmjet ideve dhe stili akademik.
Java e gjashtë:	Procesi i punimit kërkimor – zgjedhja dhe formulimi i temës, kërkimi dhe përzgjedhja e literaturës dhe përdorimi i burimeve.
Java e shtatë:	Struktura e punimit akademik – hyrja, përmbajtja, ndarja në kapituj, përfundimi, burimet dhe literatura.
Java e tetë:	Eseja akademike – struktura, formulimi i argumentit, zhvillimi i përmbajtjes dhe kriteret e vlerësimit.
Java e nëntë	Citimi, referencimi dhe integriteti akademik – citimi, parafrazimi, fusnotat, referencat dhe parimet bazë për shmangien e plagjiaturës.
Java e dhjetë	Burimet dhe bibliografia – literatura bazë dhe shtesë, burimet akademike dhe aspektet teknike të hartimit të punimit.
Java e njëmbëdhjetë	Shkrimi kritik për artin dhe dizajnin – hartimi i një recensioni dhe analiza e një vepre, projekti ose produkti vizual nga fusha përkatëse.
Java e dymbëdhjetë:	Lektura, korrektura dhe redaktimi – rishikimi gjuhësor, strukturor dhe përmbajtësor i tekstit.
Java e trembëdhjetë:	CV-ja, portfolio statement dhe letra motivuese – shkrimi dhe strukturimi i dokumenteve për aplikim akademik dhe profesional.
***Java e katërmbëdhjetë*:**	Prezantimi akademik dhe profesional – strukturimi i prezantimit, përzgjedhja e informacionit dhe prezantimi vizual dhe verbal i ideve.
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	Prezantimi dhe vlerësimi i punimeve – prezantimi i punimeve të studentëve, diskutimi, analiza dhe reflektimi mbi njohuritë dhe shkathtësitë e fituara.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët duhet të jenë të rregullt dhe aktivë në ligjërata dhe ushtrime, të realizojnë dhe dorëzojnë detyrat brenda afateve të përcaktuara dhe të respektojnë parimet e integritetit dhe

etikës akademike. Punimet duhet të jenë origjinale dhe burimet e përdorura duhet të citohen në mënyrë korrekte. Respekti ndaj kolegëve dhe mësimdhënësve, komunikimi profesional dhe pjesëmarrja konstruktive në diskutime janë të domosdoshme për një mjedis akademik bashkëpunues.